



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:060042

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05753483

KPPP.nr.687/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Tekniku” SH.P.K., me NUI: 810232851, me seli në Fshatin Lugbunar, në Gjakovë, kundër debitorit “Ventius International” L.L.C., me NUI: 810748923, me seli në rr. “Nëna Terezë” në Gjakovë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.229/23 të datës 18.04.2023, të Përmbartuesit Privat Gëzim Gjoshi me seli në Gjakovë, jashtë seancës, me datë 29.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Ventius International” L.L.C., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.229/23 i datës 18.04.2023, i Përmbartuesit Privat Gëzim Gjoshi.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.229/23 i datës 18.04.2023 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Gëzim Gjoshi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Tekniku” SH.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.229/23 të datës 18.04.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës Nr. 050622002-1 të datës 06.05.2022; Faturës Nr. 050922001-1 të datës 09.05.2022; Faturës Nr. 051822001-1 të datës 18.05.2022; Faturës Nr. 053122001-1 të datës 31.05.2022; Faturës Nr. 060122001-3 të datës 01.06.2022; Faturës Nr. 060222001-3 të datës 02.06.2022; Faturës Nr. 072722002-8 të datës 27.07.2022; Faturës Nr.

072722001-8 të datës 27.07.2022; Faturës Nr. 081622002-8 të datës 16.08.2022; Faturës Nr. 082522001-8 të datës 25.08.2022; Faturës Nr. 092022002-8 të datës 20.09.2022; Faturës Nr. 092722001-1 të datës 27.09.2022; Faturës Nr. 100722001-8 të datës 07.10.2022; Faturës Nr. 101122001-3 të datës 11.10.2022; Faturës Nr. 101822001-8 të datës 18.10.2022; Faturës Nr. 102522004-8 të datës 25.10.2022; Faturës Nr. 110822002-8 të datës 08.11.2022; Faturës Nr. 111122002-1 të datës 11.11.2022; Faturës Nr. 111722001-1 të datës 17.11.2022; Faturës Nr. 111722001-8 të datës 17.11.2022; Faturës Nr. 112522001-1 të datës 25.11.2022; Faturës Nr. 120722001-3 të datës 07.12.2022; Faturës Nr. 121622001-8 të datës 16.12.2022; Faturës Nr. 121622001-3 të datës 16.12.2022; Faturës Nr. 122322001-8 të datës 23.12.2022; Faturës Nr. 011323001-3 të datës 13.01.2023; Faturës Nr. 013023003-8 të datës 30.01.2023; Faturës Nr. 020323001-8 të datës 03.02.2023; Faturës Nr. 030123001-8 të datës 01.03.2023 dhe Faturës Nr. 031723002-8 të datës 17.03.2023; me të cilën është detyruar debitori që në emër të përmbushjes së obligimeve të papaguara nga faturat e lartcekura, brenda afatit 7 ditor nga dita e dorëzimit të urdhrorit, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 27,730.13 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data kur kredia është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore, ashtuqë të gjitha detyrimet të realizohen përmes zbatimit të përbarimit sipas llogarive bankare dhe bartjen e tyre në llogarinë e veçantë të përbaruesit privat, ndërsa nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogaritë e tij bankare, përbarimi të zbatohet përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se me kreditorin me datë 23.06.2021 kanë lidhur kontratë me anë të së cilës kreditori ka marrë përsipër furnizimin dhe vendosjen e produkteve profesionale zjarrfikëse sipas ofertës së datës 28.05.2021 nga debitori në vlerë prej 17,509.21 €, ashtuqë debitori është pajtuar që të paguaj këtë shumë, por që e njëjta është faturuar nga kreditori në shumën prej 27,730.13€. Më tutje ka shtuar se përkundër afatit 1 vjeçar të zotimit të garancionit për funksionimin e rregullt të këtyre produkteve në disa raste kjo ka dështuar, në veçanti shkaktimi i zjarrit me datës 17.10.2022 ku ka dështuar njëra nga aparatet e shuarjes, ku pas inspektimit të këtyre aparateve të zjarrit sipas raportit të brendshëm të bërë, kanë dalë së paku gjashtë aparate jashtë funksionit. Përkundër insistimit nga debitori për kryerjen e punëve dhe shërbimeve të kontraktuara nga ana e kreditorit, e njëjta nuk e ka përmbush obligimin e tij kontraktues. Në lidhje me faturat e bashkëngjitura ka theksuar se disa nga faturat nuk janë të lexueshme dhe nuk dihet as emri i personit prej të cilit pretendohet se është pranuar dhe se këto fatura nuk përmbajnë vulën e debitorit, andaj të njëjtat janë të papërshtatshme për

përmbarrim. Në fund ka deklaruar se në propozimin për përmbarrim nuk është paraqitur deklarata e kreditorit se kur është bërë e kërkueshme. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet urdhri përmbarrimor.

Kreditori në përgjigje në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke deklaruar ndër të tjerash se thirrja e debitorit në kushtet e garancionit prej 12 muajsh nuk është e vlefshme, për faktin se edhe vetë incidenti ka ndodhur jashtë këtij afati të garancionit dhe se kreditori nuk është njoftuar lidhur me incidentin e shkaktuar. Në lidhje me borxhin e cekur si në propozim ka theksuar se përbën borxh të akumuluar sipas faturave të lartcekura dhe përkundër tentimeve për inkasimin e borxhit nuk është arritur asnjë gjuhe e përbashkët nga ana e debitorit në mënyrë që të realizohet kjo pagesë. Ka deklaruar se faturat përbëjnë dokument të besueshëm dhe se debitori të njëjtat nuk i ka kundërshtuar asnjëherë, ndërsa lidhur me pretendimet e debitorit se kreditori nuk ka respektuar kushtet e kontratës, e njëjta nuk qëndron, për faktin se vetë debitori nuk ka respektuar afatin e pagesës. Sa i përket faturave të dorëzuara të njëjtat nuk janë parashkruar dhe të njëjtat përmbajnë kushtet e parapara ligjore. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri për përmbarrim të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarrim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkura dhe janë të përshtatshme për përmbarrim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Me neni 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti*

*i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.*

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm: Faturën Nr. 050622002-1 të datës 06.05.2022; Faturën Nr. 050922001-1 të datës 09.05.2022; Faturën Nr. 051822001-1 të datës 18.05.2022; Faturën Nr. 053122001-1 të datës 31.05.2022; Faturën Nr. 060122001-3 të datës 01.06.2022; Faturën Nr. 060222001-3 të datës 02.06.2022; Faturën Nr. 072722002-8 të datës 27.07.2022; Faturën Nr. 072722001-8 të datës 27.07.2022; Faturën Nr. 081622002-8 të datës 16.08.2022; Faturën Nr. 082522001-8 të datës 25.08.2022; Faturën Nr. 092022002-8 të datës 20.09.2022; Faturën Nr. 092722001-1 të datës 27.09.2022; Faturën Nr. 100722001-8 të datës 07.10.2022; Faturën Nr. 101122001-3 të datës 11.10.2022; Faturën Nr. 101822001-8 të datës 18.10.2022; Faturën Nr. 102522004-8 të datës 25.10.2022; Faturën Nr. 110822002-8 të datës 08.11.2022; Faturën Nr. 111122002-1 të datës 11.11.2022; Faturën Nr. 111722001-1 të datës 17.11.2022; Faturën Nr. 111722001-8 të datës 17.11.2022; Faturën Nr. 112522001-1 të datës 25.11.2022; Faturën Nr. 120722001-3 të datës 07.12.2022; Faturën Nr. 121622001-8 të datës 16.12.2022; Faturën Nr. 121622001-3 të datës 16.12.2022; Faturën Nr. 122322001-8 të datës 23.12.2022; Faturën Nr. 011323001-3 të datës 13.01.2023; Faturën Nr. 013023003-8 të datës 30.01.2023; Faturën Nr. 020323001-8 të datës 03.02.2023; Faturën Nr. 030123001-8 të datës 01.03.2023; Faturën Nr. 031723002-8 të datës 17.03.2023; të cilat fatura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave, është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, si dhe mbajnë nënshkrimin si dhe vulën e pranimit nga debitori.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit se në faturat e kreditorit nuk është treguar koha e përmbushjes së detyrimit monetar dhe gjeti se të njëjtat nuk gjejnë mbështetje ligjore, sepse në rastin konkret faturat i plotësojnë kushtet e përcaktuara për zbatimin e përbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, për faktin se afati i përmbushjes së detyrimit është përcaktuar në të

gjitha faturat dhe se në rastin konkret të gjitha faturat kanë arritur afatin për përmbushje në datën e lëshimit të secilës faturë.

Gjykata po ashtu vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbare prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbaremi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbaremi.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbaremit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.687/23, datë 29.05.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.